20:10

KRONIKË E ZEZË

Vrasja në Prizren dyshohet se ndodhi për shkak të një fature

15:36
Vrasja në Prizren dyshohet se ndodhi për shkak të një fature
14:02
Gjashtë të ndaluar për vrasjen në Prizren
08:50
U plagos në Prizren, një i ri vdes rrugës për në spitalin e Kukësit

15:36 Vrasja në Prizren dyshohet se ndodhi për shkak të një fature

3 janar 2023, 08:50

Vrasja e së martës në Prizren dyshohet se ka ndodhur pas konfliktit lidhur me pagesën e faturës së shërbimeve në lokalin "Kobra City", ka konfirmuar Admir Shala, kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prizren. Një 31-vjeçar me iniciale V.C. vdiq si pasojë e plagëve të marra. Ai vdiq rrugës për në spitalin e Kukësit, ku po dërgohej nga A.B. Në veturë ishte edhe R.Sh., tjetër i plagosur. Ai është jashtë rrezikut për jetë

Shala ka thënë për KOHËN se D.H., pronari i lokalit, dyshohet për veprën penale të vrasjes së rëndë.

"Sot në orën 04:10, Policia ka marrë informatën se ka pasur të shtëna në aferisi të lokalit 'Kobra City', në dalje të Prizrenit, rruga Prizren-Kukës. Dyshohet se ngjarja tragjike ka ndodhur pas një konflikti në lokalin 'Kobra City' me disa shtetas të Shqipërisë, lidhur me pagesën e faturës së shërbimeve", ka thënë Shala. "Në momentin që shtetasit V.C., R.Sh dhe A.B. po largoheshin me automjetin e tyre të markës Audi, dyshohet se shtetasi D. H. ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të automjetit të tyre".

Shala ka thënë se institucionet po ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme drejt zbardhjes së rastit.

Gjashtë persona janë ndaluar për 48 orë./*Fisnik Minci*

14:02 Gjashtë të ndaluar për vrasjen në Prizren

Policia e Kosovës ka konfirmuar se gjashtë persona janë ndaluar për 48 orë për vrasjen që ka ndodhur në orët e para të së martës, pas një ndeje në Prizren. Një 31-vjeçar nga Kukësi u plagos, ndërsa ka vdekur rrugës për në spitalin e Kukësit, sipas Policisë.

Në mesin e të ndaluarve është edhe pronari i lokalit, që dyshohet se është personi që ka shtënë në drejtim të veturës ku ishin tre shtetas të Shqipërisë.

Në këtë rast është plagosur edhe një 27-vjeçar që është jashtë rrezikut për jetë.

08:50 U plagos në Prizren, një i ri vdes rrugës për në spitalin e Kukësit

Një 31-vjeçar nga Shqipëria ka vdekur rrugës për në spitalin rajonal të Kukësit në mëngjesin e së martës, pas plagosjes në Prizren, sipas një njoftimi të Policisë së Shqipërisë.

V.C., sipas Policisë së Shtetit, bashkë me R.Sh. (të dy shtetas të Shqipërisë) dyshohet se ishin plagosur në dalje të Prizrenit, pas një konflikti në një lokal natë me disa shtetas kosovarë.

"Në Morinë, rreth orës 04:25, të mëngjesit, kanë hyrë për në drejtim të spitalit rajonal të Kukësit, shtetasit V. C., 31 vjec, dhe R. Sh., 27 vjeç, që transportoheshin me automjet nga shtetasi A. B., të tre nga Kukësi, ku shtetasit V. C., dhe R. SH , ishin të plagosur me armë zjarri në Prizren të Kosovës. Si pasojë e plagëve të marra shtetasi V. C., ka ndërruar jetë gjatë rrugës, ndërsa shtetasi R. Sh., ndodhet në spital nën kujdesin e mjekëve", thuhet në njoftim të Policisë së Shtetit.

Sipas deklarimeve të para të A.B., që i ka transportuar të plagosur për në spital, ngjarja ka ndodhur në dalje të Prizrenit. Dyshohet se në momentin kur të tre po largoheshin me veturë, D.H. ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të veturës së tyre.

Policia e Shqipërisë ka njoftuar se ka njoftuar për ngjarjen Policinë e Kosovës dhe po shkëmbejnë informacione.

Ndërsa zëdhënësi i Policisë rajonale të Prizrenit, toger Shaqir Bytyqi ka bërë të ditur se lidhur me këtë rast janë duke u intervistuar 5 persona, kryesisht stafi i lokalit ku ka ndodhur rasti. Pronari i lokalit tashmë është arrestuar. Sipas Bytyqit, po ashtu janë bastisur edhe disa lokacione. I plagosuri dëshirë transportuar në Tiranë për ndihmë më të specializuar.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Gjendet i vdekur një burrë në Podujevë
Digjen tri vetura në Pejë
Katër të lënduar në një aksident në magistralen Prishtinë-Mitrovicë
Kapet i burgosuri që u arratis derisa po transportohej për në Gjykatë
U rrahën mes vete, burrë e grua shoqërohen në stacionin policor
Një person vdes në aksident, ra në lumin Ibër në rrugën Leposaviq-Mitrovicë
Dyshohet se falsifikoi datën e vizës, lirohet në procedurë të regullt
Në Mitrovicë arrestohet i dyshuari që kanosi me jetë gruan e tij
Vjedhje e rëndë në Ferizaj, hajnat në arrati
Ferizaj, arrestohet një person për rrahjen e ish-bashkëshortes 23-vjeçare
Ndihmonin fëmijët të gjuanin me armë, Policia ua konfiskon ato dhe i liron
Digjet fabrika e stiroporit në Ferizaj, 40 mijë euro dëme materiale

YouTube
Privacy

Taboola Feed

Are you from Albania? Website design options might surprise you
Website Design Options | Search Ads | Sponsored

Online Design Courses May Get You A Job Sooner Than You Think!
Online Design Courses | Search Ads | Sponsored

Vjedhje e rëndë në Ferizaj, hajnat në arrati
Disa persona të panjohur kanë kryer një vjedhje në një shtëpi në Ferizaj, njoftoi Policia e Kosovës të martën. Sipas pronarit të shtëpisë, të dyshuarit kanë hyrë me forcë në shtëpi derisa ai nuk ishte...
Kohanet

Albania:The Cost Of Solar Panels May Surprise You(See Prices)
Best Solar Panel System | Sponsored

KOMENTO: Ne çmojmë mendimin tuaj. Prandaj kemi rikthyer seksionin e komenteve. Më poshtë mund të komentoni këtë artikull. Klikoni për të shkuar drejt të komentimit.

#FLAGOSJE #VDEKJE

TË FUNDIT

Gjendet i vdekur një burrë në Podujevë

Digjen tri vetura në Pejë

Katër të lënduar në një aksident në magistralen Prishtinë-Mitrovicë

Kapet i burgosuri që u arratis derisa po transportohej për në Gjykatë

U rrahën mes vete, burrë e grua shoqërohen në stacionin policor

Një person vdes në aksident, ra në lumin Ibër në rrugën Leposaviq-Mitrovicë

Dyshohet se falsifikoi datën e vizës, lirohet në procedurë të regullt

Në Mitrovicë arrestohet i dyshuari që kanosi me jetë gruan e tij

Vjedhje e rëndë në Ferizaj, hajnat në arrati

Ferizaj, arrestohet një person për rrahjen e ish-bashkëshortes 23-vjeçare

Ndihmonin fëmijët të gjuanin me armë, Policia ua konfiskon ato dhe i liron

Digjet fabrika e stiroporit në Ferizaj, 40 mijë euro dëme materiale

BALLINA LAJME ZGJEDHJET 2021 KRONIKË KULTURË MES PËR MES VËSHTRIME SPORT HOROSKOPI PODCAST VIDEO MREKULLIA

KOHA
Marketing Politika e privatësisë Kushtet e përdorimit +383 (0) 38 249 105 info@koha.net
Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Khorsh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Partnerët:
Shkabaj

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të jëndosen për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i pasaktësisë qëllimi original apo i modifikuar në çfardo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe internetit a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të kreut njëjës qe e përbërjës (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe AETA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjitha shkeljet e këtyre të drejtave do të ndëshkohen me ligjin.